REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
Nr. 17819 aktit

17819

VENDIM
"PËR REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK"

Në Tirane, sot në datë 2 / 10 / 1997, une gjyqtare eGjykates se Rrethit Tirane Gëzuela Copo mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Z. Werner Mehlber dhe Zj. Elona Mehlber për regjistrimin si person juridik të shoqërisë **"Albania Duty Free Distribution" Sh.p.k.**

KONSTATOVA

se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit Z. Werner Mehlber dhe Zj. Elona Mehlber për regjistrimin si person juridik te shoqërisë **"Albania Duty Free Distribution" Sh.p.k.** për ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen e biznesit të "Duty Free Shops", nëpërmjet importit të mallrave që tregtohen në këtë rafsh, si: parfume, artikuj kozmetikë, aksesorë të ndryshëm, paisje elektronike, likerna e pije të ndryshme, cigare etj., në përputhje me ligjet e Shtetit dhe udhëzimet e Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet hapjes së dyqaneve e njësive tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë aeroportet, portet, njësitë në zonat kufitare dhe trupin diplomatik të akredituar në Shqipëri, është e drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTË ARSYE

Në bazë të ligjit 7667 datë 28/01/1993 dhe ligjit 7638 datë 19/11/1992

VENDOSA

Regjistrimin si person juridik te shoqerise **"Albania Duty Free Distribution" Sh.p.k.** per ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen e biznesit të "Duty Free Shops", nëpërmjet importit të mallrave që tregtohen në këtë rafsh, si: parfume, artikuj kozmetikë, aksesorë të ndryshëm, paisje elektronike, likerna e pije të ndryshme, cigare etj., në përputhje me ligjet e Shtetit dhe udhëzimet e Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet hapjes së dyqaneve e njësive tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë aeroportet, portet, njësitë në zonat kufitare dhe trupin diplomatik të akredituar në Shqipëri

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.
- Selia e shoqërisë është: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Veve Business Center 74, Tiranë.
- Kohëzgjatja e shoqërisë është 10 vjet.
- Administratorë të shoqërisë janë Werner Mehlber dhe Elona Mehlber.
- Ortakë të shoqërisë janë Werner Mehlber dhe Elona Mehlber.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në shkallë të dytë.

GJYQTARE

Ermira Copo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 17819/6746 Akti

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me 22.06.1999, perpara meje A. Caj. e Gjyqtare prane Gjykates se rrethit Tirane, u paraqit Z. Elona MEHLBER, e ija e Shpétimit, lindur 24.05.1971, banuese ne Tirane, Bulevardi Zhane D'Ark, P.2, Sh.3, Ap.17, administratore e shoqerise "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION"shpk e cila me paraqiti kerkesen per depozitim ne Regjistrin Tregtar te vendimit N.1 date 21.06.1999 qte asamblese se jashtezakonshme te shoqerise "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" dhe dokumentet perkatese, nga te cilet

KONSTATOVA

- Se me date 21.06.1999 ne Tirane eshte zhvilluar mbledhje e asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" shpk, e cila vendosi:

1- Te emeroje Znj. Elona MEHLBER administratore te shoqerise.
2- Te shtoje nje paragraf ne nenin 18 duke e numertuar 18.3 ku parashikohet se:
"Administratori ka te drejta te cdo lloji, te lidhura me drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe qe synojne permbushjen dhe realizimin e objektit te shoqerise, te drejta keto qe nga ligji nuk jane njohur taksativisht per asamblene e jashtezakonshme te ortakeve.
Administratori I vetem ka te drejten e firmes perfaqesuese te shoqerise perballe te treteve dhe ne gjykim, me te drejten qe te kryeje verpime, procedura ne shkalle te ndryshme gjykimi dhe te administrates shteterore.
Administratori ka te drejten e firmes perfaqesuese te shoqerise perballe bankes apo bankave ku jane hapur llogarite e shoqerise, duke pasur te drejte te urdheroje derdhje, terheqje, transferta te parave, te drejten te urdheroje kryerjen e procedurave te ndryshme bankare si urdherim garancie bakare, leshim leter kreditit, terheqje dhe pranim kredie bankare, ngurtesim fondesh, etj.
Administratori I vetem mund te emeroje nje drejtor te ndermarrjes apo nje drejtues teknik dhe midis personave jashte shoqerise duke vendosur shperblimet perkatese per ta.
Administratori I vetem mund te delegoje pjese te te drejtavedhe kompetencav ete tij, perfshire dhe te drejten e perdorimit te frmes se shoqerise nje ose disa perfaqesuesve te vecante, duke I caktuar ketyre kompetencat, funksionet dhe shperblimet.
Shperblimi per administratorin e vetem, pertej shpenzimeve te nevojshme per mbajtjen e zyres se tij, vendoset nga asambleja e ortakeve.
Administratori qe nuk ka marre pelqimin e asamblese se ortakeve, nuk mund te jete ortak ne shoqeri konkurente dhe nuk mund te ushtroje per llogari te vet aktivitete konkuruese me objektin shoqerore te shoqerise.
gjithashtu konstatova se kerkesa per depozitimin ne Regjistrin Tregtar te ketij vendimi eshte e bazuar ne ligj, dhe

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit Nr. 7667, dt. 28.02.2993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare";

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimit n.1 date 21.06.1999 te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "ALBANIN DUTY FREE DISTRIBUTION" sh.p.k, sipas se cilit:
1- Znj. Elona MEHLBER emerohet administratore e shoqerise.
2- Neni 18 shtohet me nje paragraf qe numertohet 18.3 ku parashikohet se:
"Administratori ka te drejta te cdo lloji, te lidhura me drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe qe synojne permbushjen dhe realizimin e objektit te shoqerise, te drejta keto qe nga ligji nuk jane njohur taksativisht per asamblene e jashtezakonshme te ortakeve.
Administratori I vetem ka te drejten e firmes perfaqesuese te shoqerise perballe te treteve dhe ne gjykim, me te drejten qe te kryeje verpime, procedura ne shkalle te ndryshme gjykimi dhe te administrates shteterore.
Administratori ka te drejten e firmes perfaqesuese te shoqerise perballe bankes apo bankave ku jane hapur llogarite e shoqerise, duke pasur te drejte te urdheroje derdhje, terheqje, transferta te parave, te drejten te urdheroje kryerjen e procedurave te ndryshme bankare si urdherim garancie bakare, leshim leter kreditit, terheqje dhe pranim kredie bankare, ngurtesim fondesh, etj.
Administratori I vetem mund te emeroje nje drejtor te ndermarrjes apo nje drejtues teknik dhe midis personave jashte shoqerise duke vendosur shperblimet perkatese per ta.
Administratori I vetem mund te delegoje pjese te te drejtavedhe kompetencav ete tij, perfshire dhe te drejten e perdorimit te frmes se shoqerise nje ose disa perfaqesuesve te vecante, duke I caktuar ketyre kompetencat, funksionet dhe shperblimet.
Shperblimi per administratorin e vetem, pertej shpenzimeve te nevojshme per mbajtjen e zyres se tij, vendoset nga asambleja e ortakeve.
Administratori qe nuk ka marre pelqimin e asamblese se ortakeve, nuk mund te jete ortak ne shoqeri konkurente dhe nuk mund te ushtroje per llogari te vet aktivitete konkuruese me objektin shoqerore te shoqerise.
Urdherohet Zyra e Rregjsitri Tregtar te beje ndryshimet perkatese.
Kunder ketij vendimi mund te behet ankim.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 1718/2 VENDIMI

V E N D I M
"I GJYQTARIT TE VETEM "

Sot, me date 23./ 03 / 2004 ,une Gjyqtare [illegible] prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane , pasi shqyrtova materialet e paraqitura nga kerkuesja ne emer te shoqerise "Albania Duty Free Distribution " sh.p.k ,

K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr 1718 19 date 02.010.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare e emertuar "Albania Duty Free Distribution " sh.p.k, me ortake themelues Werner dhe Elona Mehlber,me kapital themeltar 100.000 leke,administratore zj.Elona Mehlber,dhe objekt te veprimtarise i cili gjendet i pasqyruar me detaje ne aktet e krijimit te kesaj shoqerie.

Me vendimin nr 2 date 12.03.2004 te asamblese se ortakeve te shoqerise eshte vendosur: Largimin nga shoqeria te ortakut Werner Mehlber,miratimi i shitjes se kuotave qe disponon ne shoqeri ortaku Werner Mehlber ne masen 50 % tek ortaku tjeter i shoqerise Elona Mehlber. Me kete shitje ortake e vetme shoqerise do te mbetet Elona Mehlber e cila pas ketij veprimi do te disponoje totalisht 100 % te kapitalit te shoqerise,si dhe depozitimin e ketij vendimi prane rregjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Per sa me lart kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare "

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane rregjistrit tregetar te vendimit nr 2 date 12.03.2004 te asamblese ortakeve te shoqerise "Albania Duty Free Distribution " sh.p.k si dhe te kontrates se shitjes se kuotave nr 1049 Rep/93 Kol date 12.03.2004.

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te rregjistrit.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR VENDIMI
1271P 3

VENDIM
"I GJYQTARIT TE VETEM "

Sot, me date 25/1 / 2006 ,une Gjyqtare.....G.Z.....K..., prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , pasi shqyrtova materialet e paraqitura nga kerkuesja ne emer te shoqerise "Albania Duty Free Distribution" sh.p.k ,

KONSTATOVA

Se me vendimin nr 17719 date 02.10.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare e emertuar "Albania Duty Free Distribution" sh.p.k, me ortake dhe njekohesisht administratore te saj zj.Elona Mehlber , me seli ne Rr"B.Curri"Tirane, dhe objekt te veprimtarise i cili gjendet i pasqyruar me detaje ne aktet e krijimit te kesaj shoqerie.

Me vendimin nr 3 date 18.01.2006 te ortakut te vetem te shoqerise eshte vendosur: ndryshimin e selise se shoqerise ne Qendra Biznesit " VEVE CENTER ",Bulevardi " Zogu I- re ", si dhe depozitimi i ketij vendimi prane rregjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Per sa me lart kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare "

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane rregjistrit trgetar te vendimit nr 3 date 18.01.2006 te ortakut te vetem te shoqerise "Albania Duty Free Distribution" sh.p.k ne lidhje me ndryshimin e selise se shoqerise.

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te rregjistrit.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR. 17719 / 4 VENDIMI

17828/4

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Une gjyqtarja e vetme .....e.....; ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane, sot ne date 04.01.2007 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga **zj.Elona Mehlber** per depozitimin e akteve ne emer te shoqerise:

KONSTATOVA:

Me vendim te gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr. 17719 date 02.10.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare "**ALBANIA DUTY FREE DISTRIBUTION**" sh.p.k. me ortak te vetem njekohesisht dhe administrator zj Elona Mehlber, me seli te ndodhur ne Tirane,dhe objekt veprimtarie i cili gjendet i detajuar ne aktet e krijimit te shoqerise.

Me vendimin nr 4 date 29.12.2006te ortakut te vetem eshte vendosur shtimi i afatit te veprimtarise se shoqerise per nje afat te pacaktuar, si dhe depozitimin e ketij vendimi prane rregjitrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregetar te vendimit nr.4 date 29.12.2006 te Ortakut te Vetem te shoqerise"**ALBANIA DUTY FREE DISTRIBUTION**" sh.p.k. per Shtimin e afatit te veprimtarise se shoqerise per nje afat te pacaktuar.

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregetar ne kollonen 4 dhe 5

GJYQTARE

( )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR VENDIMI
17819/5

VENDIM
"I GJYQTARIT TE VETEM "

Sot, me date 09 / 05 / 2007 ,une Gjyqtare BLERINA MUCA, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , pasi shqyrtova materialet e paraqitura nga kerkuesja ne emer te shoqerise "ALBANIA DUTY FREE DISTRIBUTION " sh.p.k,

KONSTATOVA

Se, me vendimin nr 17819 date 02.10.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare e emertuar " ALBANIA DUTY FREE DISTRIBUTION "sh.p.k,me ortake themelues njekohesisht administratore te saj zj.Elona Mehlber (Caushi),kapital themeltar 100.000 leke,seli te ndodhur ne Tirane, dhe objekt te veprimtarise i cili ndodhet i detajuar ne aktet e krijimit te kesaj shoqerie.

Me vendimin date 20.03.2007 te ortakut te vetem shoqerise eshte vendosur:pranimi i shoqerise " GEBR.HEINEMANN ALBANIEN HOLDING " Gmbh i rregjistruar ne Gjykaten e Hamburgut Gjermani , me nr rregjistri HRB 99537,me seli te rregjistruar ne adrese :Magdeburger Strasse 3, 20457 Hamburg,Gjermani e perfaqesur nga administratori i shoqerise z.Jens Georg DEGNER,te nenshkruaje kontrate shitje kuotash ne favor te shoqerise "GEBR.HEINEMANN ALBANIEN HOLDING "Gmbh per nje total prej 70% te kuotave,per cmimin kontraktor prej 70.000 (shtatedhjetemije) leke.Me nenshkrimin e kontrates se shitjes se kuotave , pjesmarrja ne kapitalin e shoqerise paraqitet si vijon:1-Elona Mehlber CAUSHI – 30 % e kuotave te shoqerise,2- GEBR.HEINEMANN ALBANIENN HOLDING SHPK – 70 % te kuotave te shoqerise,Zj Elona Mehlber Caushi mbetet ne detyren e administratorit te shoqerise, si dhe depozitimin e ketij vendimi prane rregjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Transferimi i kuotave te kapitalit eshte realizuar nepermjet kontrates se shitjes se kuotave nr 384 Rep/139 Kol date 20.03.2007 perpiluar nga notere Gentiana Shkodra.

Per sa me lart kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare "

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane rregjistrit tregetar te vendimit date 20.03.2007 te ortakut te vetem te shoqerise "ALBANIA DUTY FREE DISTRIBUTION " sh.p.k si dhe te kontrates se shitjes te kuotave nr 384 Rep/139 Kol date 20.03.2007 perpiluar nga notere Gentiana Shkodra.

Te pasqyrohen ndryshimet ne kolonat perkatese te rregjistrit.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

GJ Y Q T A R E

BLERINA MUÇA

URDHER REGJISTRIMI

14819

1. "Albania Duty Free Distribution" sh.p.k.

2.a 100.000 lekë

b nënë 10 vjet

c import mallrash si parfume, artikuj kozmetikë, shkrimore të ndryshëm, pajisje elektronike etj.

c Me seli Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Veve Business Center 74 Tirana

3. Me ortak z. Werner Mehlber dhe zj. Elona Mehlber dhe administrator të shoqërisë jemi z. Werner Mehlber dhe zj. Elona Mehlber

4. Statuti nënshkruar me date 2.10.1997.

5. Data e regjistrimit 2.10.1997.

Statuti 5 Flete

Njoftime: a. shoqeria

b. dhomen e tregtise

c. organit perkates financiar

d. zyres se statistikes

Publikime NO 3607408

GJYQTARE

Anila Cap

A K T - T H E M E L I M I
I SHOQERISE "ALBANIA DUTY FREE DISTRIBUTION" L.t.d.
(A. D. F. D.)

N e n i 1

Werner Mehlber, me adresë: Rr. B. Curri, Pall. 85/1, Ap. 2, TIRANA / ALBANIA, dhe Elona Mehlber me adresë: Rr. B. Curri, Pall. 85/1, Ap. 2, TIRANA, ALBANIA, themelojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "Albania Duty Free Distribution" Sh. p. k. .

N e n i 2

Shoqëria ka Statutin e personit juridik dhe selinë e saj në Veve Business Center 74, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë.

N e n i 3

Veprimtaria e Shoqërisë, marrëdhëniet që lindin nga ky akt themelimi dhe marrëdhëniet e Shoqërisë me persona të tretë juridikë e fizikë, vendas e të huaj, rregullohen nëpërmjet dispozitave të kësaj kontrate e Statuti të bashkëlidhura dhe të ligjit Nr. 7638 datë 19. 11. 1992.
Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj, ajo nuk mund të përgjigjet tej kapitalit të saj themelor. Po kështu, edhe ortakët e sipërpërmendur, përgjigjen vetëm me kapitalin themelor të vënë prej tyre.

N e n i 4

Jetëgjatësia e Shoqërisë është 10 vjet.

N e n i 5

Shoqëria "Albania Duty Free Distribution" L.t.d. e zhvillon aktivitetin e saj në fushën e biznesit të "Duty Free Shops", nëpërmjet importit të mallrave që tregtohen në këtë rrafsh, si : parfume, artikuj kozmetikë, aksesorë të ndryshëm, pajisje elektronike, likerna e pije të ndryshme, cigare, etj., në konformitet me ligjet e shtetit dhe udhëzimet e qeverisë shqiptare, nëpërmjet hapjes së dyqaneve e njësive tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë aeroportet, portet, njësitë në zonat kufitare dhe trupin diplomatik të akredituar ne Shqipëri.
Firma ka të drejtën që, në respektim të ligjeve përkatëse shqiptare, të hapë zyra përfaqësuese brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Veprimtaria e Shoqërisë, emërtimi dhe Selia e saj nuk mund të ndryshojnë pa vendim kolegjial të ortakëve të shoqërisë.

Neni 7

Aksionet e shoqërisë " Albania Duty Free Distribution " L.t.d. ndahen midis ortakëve si më poshtë:

1.Werner	Mehlber	50% (pesëdhjetë për qind)
2.Elona	Mehlber	50% (pesëdhjetë për qind)

Në bazë të këtij raporti aksionesh, bëhet kontributi si edhe shpërndarja e fitimit të secilit ortak.

Neni 8

Kapitali i Shoqërisë është në shumën 100.000 lekë, por ky kapital themelor edhe mund të shtohet apo të pakësohet. Në kapitalin themelor janë ortakët e sipërmendur, kuotat e kapitalit themelor takojnë tërësisht ortakëve, bazë përqindjes së aksioneve të futura nga secili .
Ky kapital është i shlyeshëm dhe regjistrohet në librin e llogarisë së Shoqërisë, në të cilin krijohet "Fondi Themelor i Shoqërisë". Ortakët nuk kufizohen në rritjen e kontributit të tyre në kapitalin themelor.
Ky kapital mund të depozitohet edhe në njërën nga bankat në Tiranë, ku Shoqëria hap llogarinë e saj rrjedhëse.

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqëria, pas zbritjes së detyrimeve ligjore dhe fondeve të përcaktuara, merret tërësisht nga Ortakët dhe përdoren sipas interesit të tyre, por edhe për të shtuar kapitalin themelor të Shoqërisë.

Neni 10

Organet e Shoqërisë janë:
1. **Këshilli i ortakëve** (që zgjedhin administratorin, drejtorin e përgjithshëm ose presidentin e saj.)
2. **Komisioni i revizionimit,** ose ekspertët kontabël.
Modalitetet e formimit dhe funksionimit të këtyre organeve përcaktohen në Statutin e bashkëlidhur.

Neni 11

Dispozita më të hollësishme për Shoqërinë përcaktohen në Statutin që i bashkëngjiten këtij akti.

Neni 12

Ky Akt - Themelimi u redaktua në katër kopje, nga të cilat njëra dorëzohet në Zyrën e Noterisë në Tiranë, një kopje në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, një kopje në Zyrën e Tatimeve dhe një kopje mbahet në dokumentacionin e Shoqërisë.

O R T A K Ë T

Werner MEHLBER

Elona MEHLBER

Tiranë, me

STATUT
I SHOQERISE "ALBANIA DUTY FREE DISTRIBUTION" L.t.d.
(A. D. F. D.)

Neni 1

Shoqëria "Albania Duty Free Distribution" Sh. p. k. , është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përfaqësohet nga Ortakët Werner Mehlber me adresë: Rr. B. Curri, Pall. 85/1, Ap. 2, TIRANA, ALBANIA dhe Elona Mehlber me adresë: Rr. B. Curri, Pall 85/1, Ap. 2, TIRANA, ALBANIA, të cilët janë edhe administratorët e saj.

Neni 2

Shoqëria ka këtë Statut në pëputhje me Aktin e Themelimit dhe Ligjen Nr. 7638 datë 19. 11. 1992, që rregullon pozitën juridike të Shoqërisë me punonjësit e saj, të dhënat me rëndësi për rregullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarisë të Shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndsi për punën e saj.

Neni 3

Shoqëria ka **statusin e personit juridik** dhe vulën e saj, ajo e ka fituar këtë të drejtë me vendimin Nr. ..... datë ..... 199... .

Neni 4

Shoqëria "Albania Duty Free Distribution" L. t. d. e zhvillon aktivitetin e saj në fushën e biznesit të "Duty Free Shops", nëpërmjet importit të mallrave që tregtohen në këtë rrafsh, si : parfume, artikuj kozmetikë, aksesorë të ndryshëm, pajisje elektronike, likerna e pije të ndryshme, cigare, etj., në konformitet me ligjet e shtetit dhe udhëzimet e qeverisë shqiptare, nëpërmjet hapjes së dyqaneve e njësive tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë aeroportet, portet, njësitë në zonat kufitare dhe trupin diplomatik të akredituar në Shqipëri.

Neni 5

Jetëgjatësia e Shoqërisë është 10 vjet, përveç ndonjë zgjdhje tjetër të parakohshme apo zgjatje të këtij afati.

Neni 6

Selia e Shoqërisë është në Veve Business Center 74, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, por ajo ka te drejtë të çelë degë, filiale, apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar apo jashtë tij.

Neni 7

Kapitali themelor i Shoqërisë është në shumën 100.000 lekë, dhe është i depozituar proporcionalisht nga ortakët e shoqërisë në bazë të raporteve të aksioneve të vendosura, por kjo shumë me vendim të ortakëve mund të shtohet ose të pakësohet. Mbi këtë bazë, ortakët kanë të drejtë të bëjnë riorganizimin e firmës në një formë tjetër.

Neni 8

Ortakët si pjesëtarë në kapitalin themelor, ruajnë të drejtën e tyre të pronësisë në Shqipëri.

Neni 9

Pjesëmarrja në këtë Shoqëri nuk i pengon Ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative apo të drejta të tjera pronësie jashtë Shoqërisë. Ata nuk i nënshtrohen Shoqërisë si persona dhe nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë tej kapitalit themelor të saj.

Neni 10

Marrja në punë në Shoqëri bëhet me anë të kontratës së punës, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve në përputhje me ligjen për marrjen në punë.

Neni 11

Shoqëria përcakton Fondin Themelor dhe Fondin Rezervë. Gjatë veprimtarisë së saj, ajo mund të përcaktojë edhe fonde të tjera. Fondi Themelor i Shoqërisë përbëhet nga kapitali themelor i investuar nga Ortakët dhe ai përdoret për punët e Shoqërisë, por edhe për të mbuluar rreziqet, por gjithnjë pas shfrytëzimit të Fondit Rezervë.
Shoqëria disponon plotësisht mjetet e saj financiare.
Detyrimet eventuale, që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, mbulohen nga Fondi Rezervë por edhe nga fonde të tjera, ose nga shumat eventuale suplementare që mund të derdhin ortakët e shoqërisë, kur këto detyrime nuk mbulohen nga fondet ekzistuese.

Neni 12

Shoqëria me vendim të Ortakëve themelues të shoqërisë mund të pranojnë në të edhe ortakë të tjerë, me kapitale të sjella nga jashtë, duke i investuar në kapitalin themelor ose duke blerë kuota brenda kapitalit themelor të Shoqërisë. Kuota e kapitalit të tyre shënohet në librin e llogarisë së Shoqërisë.

Neni 13

Shoqëria është pronare për ato sende që gëzon këtë të drejtë. Ajo ka të drejtë të përfitojë edhe të drejta të tjera materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për të ofruar pasuritë e veta.

Neni 14

Kur Shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjithë detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit ia jep Ortakëve.

Neni 15

Fitimi i realizuar nga Shoqëria merret nga Ortakët dhe përdoret në bazë të interesit të tyre, por edhe për të shtuar kapitalin themelor të Shoqërisë.

Neni 16

Rrezikun e humbjeve eventuale ne afarizmin e Shoqerise e mbartin Ortakët e saj, sipas kapitalit themelor te Shoqerise. Humbjet kompesohen nga e tere pasuria e Shoqerise.

Neni 17

Pasuritë e Shoqërisë vlerësohen në bilancet e saj të vlerësuar në lekë, ne përputhje me Ligjen **"Mbi kontabilitetin"**.
Forma e bilanceve dhe llogarive ekonomike caktohen nga Ortakët në rolin e Drejtorit të Përgjithshëm (ose Presidenti), duke patur parasysh dhe formën e bilanceve dhe llogarive ekonomike të personave të tjerë juridikë dhe fizikë e të organizmave të tjerë. Bilancet vjetore duhen të paraqiten brenda datës ..... të vitit paraardhës.

Neni 18

Organet e Shoqërisë janë:

1. **Këshilli i ortakëve:**
   Mr. Werner MEHLBER, President
   Mrs. Elona MEHLBER, Vice-President.

2. **Komisioni i Revizionit** ose ekspertët kontabël.

Neni 19

Këshilli i ortakëve përfaqëson organin vendimor në Shoqëri, ai përcakton drejtimet kryesore të punës së Shoqërisë, vendos për bilancin vjetor, vendos për ndryshimet në Statut, për shtimin e pakësimin e kapitalit themelor, për pranimin e Ortakëve të rinj, për pushimin e veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 20

Ortakët në rolin e Administratorit përfaqësojnë organin vendimor në Shoqeri. Ata kanë të drejtë të miratojnë programet dhe llogaritë ekonomike, miratojnë bilancin vjetor, emërojnë dhe shkarkojnë Komisionin e Revizionimit, çelin letër kredite në lek ose në valutë të huaj, përfaqësojnë shoqërinë në të tretët, lidhin kontrata, përcaktojnë numrin e punonjësve dhe pagat e tyre.

Neni 21

Veprimtaria operative e Shoqërise administrohet nga Ortakët në rolin e Drejtorit të Përgjithshëm, i cili vepron në të gjithë sektorët e Shoqërisë, për të ndjekur dhe realizuar veprimtarinë e përcaktuar në objektin e aktivitetit të Shoqërisë. Ortakët në rolin e Drejtorit të Përgjithshëm kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë me persona të tretë, lidhin dhe nënshkruajnë kontrata në emër dhe për llogari të Shoqërisë, i ndjekin dhe i realizojnë ato, bëjnë emërimin e punonjësve në Shoqëri dhe pushimin e tyre nga pune në rast se veprimet e tyre bien ndesh me intersat e Shoqërisë apo me kontratën e punës të lidhur me ta.

N e n i 22

Ortakët kanë të drejtë që, me anë të prokurave të veçanta, të emërojë në postin e Administratorit dhe të Drejtorit të Përgjithshëm edhe persona të tjerë, duke i dhënë atyre të drejta si ato që ndodhen në Statut apo të dreja të tjera. Këto prokura në çdo kohe janë të revokueshme.

N e n i 23

Për të kontrolluar veprimtarinë financiare dhe atë ekonomiko-tregtare, Ortakët emërojnë Komisionin e Revizionimit ose të ekspertëve kontabël, të përbërë nga një Kryetar dhe nga një ose më shumë anëtarë. Këta emërohen për një periudhë kohe të caktuar dhe nuk duhet të jenë punonjës të Shoqërisë apo të filialeve të mundshme të saj.
Ky komision i paraqet raporte me shkrim Ortakëve për kontrollet që bën.

N e n i 24

Kur Shoqëria kërkon të pushojë veprimtarinë e saj, Ortakët emërojnë Komisionin e Likujdimit, i cili duhet të paraqesë bilancin e saj.
Shoqëria pushon veprimtarinë e saj kur Ortakët miratojnë bilancin e likujdimit. Mjetet financiare të fituara merren nga Ortakët, pasi bëhet pagesa për kreditorët.

N e n i 25

Ky Statut u redaktua në katër kopje, nga të cilat njëra dorëzohet në Zyrën e Noterisë në Tiranë, një kopje në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, një kopje në Zyrën e Tatimeve dhe një kopje mbahet në dokumentacionin e Shoqërisë.

O R T A K Ë T

Werner MEHLBER

Elona MEHLBER

Tiranë, me

Nr. 465/2007 T

Me anë të së cilës unë vërtetoj nënshkrimin e mësipërm si të vërtetë dhe të realizuar në prezencën time prej

1 Z. Claus Heinemann,
datëlindje: 7 gusht 1950,
adresa punës : Magdeburger Straße 3, 20457 Hamburg, Germany,
njohur personalisht nga unë,

Që vepron si partner i besueshëm personalisht me autoritetin e bashkë-përfaqësimit të Gebr. Heinemann, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve Gjermane me seli statutore në Hamburg/Gjermani dhe regjistruar pranë Regjistrit Tregtar të Hamburg me regjistrim numër HRA 15017, adresa : Magdeburger Straße 3, 20457 Hamburg, Germany,

2 Z. Gunnar Heinemann,
datëlindje: 6 Janar 1951,
adresa punës : Magdeburger Straße 3, 20457 Hamburg, Gjermani,
njohur personalisht nga unë,

që vepron si partner i besueshëm personalisht me autoritetin e bashkë-përfaqësuesit të shoqërisë si më sipër Gebr. Heinemann.

Duke u bazuar në regjistrimin përkatës pranë Regjistrit Tregtar të Hamburg, unë këtu vërtetoj në përputhje me Seksion. 21 të Aktit Federal të Noterisë (§ 21 BNotO) se nën numrin e regjistrimit HRA 15017 z.Claus Heinemann dhe z. Gunnar Heinemann janë regjistruar si personalisht të besueshëm , secili me autoritet për bashkë-përfaqësimi.

-Hamburg, më 19 mars 2007

Dr. Till Kleinstück, Noter Publik
- komisioni im është pa datë skadimi -

Përkthim i vërtetë dhe i saktë nga gjuha Gjermanisht në gjuhën Shqipe

---

Përkthyes / Oriol Spaho

ORIOL SPAHU

REPUBLIKA SHQIPËRISË
DHOMA NOTERISË TIRANË
Nr. 361 Rep.

VËRTETIM

Në Tiranë, sot më datë 20/03/2007, para meje noter _____, anëtar i Dhomës Noterëve dhe me zyrë noteriale në Tiranë, u paraqit në cilësinë e përkthyesit, z. Oriol SPAHO, regjistruar me vendim N⁰ 30816 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, dhe me NIPT K 51501007B, pranë Z.T.Tx. Tiranë, i njohur zyrtarisht prej meje, cili më deklaroi se përktheu dokumentin bashkangjitur , Prokurë, datë 19/03/2007, për llogari të shoqërisë Gebr. Heinemann Albanien Holding GmbH, nga Anglisht në Shqip dhe nënshkroi sipas rregullave .

Noter

DOLLE-TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA SHQIPËRISË
DHOMA NOTERISË TIRANË
Nr. 360 Rep.

V Ë R T E T I M

Në Tiranë, sot më datë 20 / 03/2007, para meje noter _____, anëtar i Dhomës Noterëve dhe me zyrë noteriale në Tiranë, u paraqit në cilësinë e përkthyesit, z. Oriol SPAHO, regjistruar me vendim N⁰ 30816 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, dhe me NIPT K 51501007B, pranë Z.T.Tx. Tiranë, i njohur zyrtarisht prej meje, cili më deklaroi se përktheu dokumentin bashkangjitur , Prokurë, datë 19/03/2007, për llogari të shoqërisë Gebr. Heinemann Albanien Holding GmbH, nga Gjermanisht në Shqip dhe nënshkroi sipas rregullave .

N o t e r

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

Notere Gentiana Shkodra
M. Shyri, P.44, Sh.1, Ap.1, Tirane
Rep.....419.....

VERTETIM

Vertetoj sot me date 08.05.2007 une notere Gentiana Shkodra, me studio ne Tirane, ne rrugen M.Shyri, P.44, Sh.1, Ap.1, anetare e Dhomes se Noterise Tirane,

Se akti bashkengjitur:

Akt nr. UR – Nr 470 2007 i noter Dr. Till Kleinstuck

ESHTE NJE KOPJE E NJEJTE ME ORIGJINALIN

Sa me lart garantohet me firmen dhe vulen time zyrtare. Vertetimi leshohet ne baze te nenit 56 te ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" dhe Udhezimit te Ministrise se Drejtesise n. 6291 date 17.08.2005, pika 3,4,7.

Gentiana SHKODRA
NOTER

100 LEKE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

Notere Gentiana Shkodra
M. Shyri, P.44, Sh.1, Ap.1, Tirane
Rep.....

VERTETIM

Vertetoj sot me date 08.05.2007 une notere Gentiana Shkodra, me studio ne Tirane, ne rrugen M.Shyri, P.44, Sh.1, Ap.1, anetare e Dhomes se Noterise Tirane,

Se akti bashkengjitur:

Akt date 19.03.2007 i noter Dr. Till Kleinstuck

ESHTE NJE KOPJE E NJEJTE ME ORIGJINALIN

Sa me lart garantohet me firmen dhe vulen time zyrtare. Vertetimi leshohet ne baze te nenit 56 te ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" dhe Udhezimit te Ministrise se Drejtesise n. 6291 date 17.08.2005, pika 3,4,7.

Gentiana SHKODRA
NOTER

LE TAKSE
100 LEKE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

Z. B. Rusa
dt. 10.04.2007

10 APR. 2007

KERKESE 17819/5

Kerkues: **Znj. Elona Mehlber Caushi**, e bija e Shpetimit, lindur ne Tirane, me 24.05.1971, banuese ne Tirane, Rr. Brigada 8, 7.3 me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes nr.Z1344896, ne cilesine e administratorit te vetem te Shoqerise "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" Sh.p.k., person juridik ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin nr.7719 date 02.10.1997, me seli te rregjistruar ne Tirane, ne adresen: Bulevardi Zogu I, Veve Business Center

Objekti: Depozitim ne rregjistrin tregtar te Vendimit te Ortakut te Vetem te Shoqerise "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" Sh.p.k. date 20.03.2007

Baza ligjore: Neni 28 i Ligjit nr. 7632 date 04.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar:, Neni 1,2,33 i Ligjit n. 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", nenet 40, 62 te Ligjit n.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

PER KOMPETENCE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Shoqeria "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" Sh.p.k. eshte krijuar me vendimin nr.7819 date 02.10.1997 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ortaku i vetem i shoqerise me vendimin date 20.03.2007 vendosi:

1. Te pranoj shoqerine **"GEBR.HEINEMANN ALBANIEN HOLDING" Gmbh** person juridik ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, rregjistruar ne Gjykaten e Hamburgut Gjermani, me numer rregjistri HRB 99537, me seli te rregjistruar ne adresen: Magdeburger Strasse 3, 20457 Hamburg, Gjermani, e perfaqesuar nga administratori i shoqerise Z.Jens Georg DEGNER.
2. Te nenshkruaj kontrate shitje kuotash ne favor te shoqerise **"GEBR.HEINEMANN ALBANIEN HOLDING" Gmbh** per nje total prej 70% te kuotave, per emnimin kontraktor prej 70.000 (shtatedhjetemije) leke.
3. Me nenshkrimin e kontrates se shitjes se kuotave, pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise paraqitet si vijon:
   1. Elona Mehlber CAUSHI - 30% e kuotave te shoqerise
   2. GEBR. HEINEMANN ALBANIEN HOLDING SHPK - 70% te kuotave te shoqerise

   100% te kuotave te kapitalit te shoqerise
4. Znj. Elona Mehlber CAUSHI riemerohet ne detyren e administratorit te shoqerise.
5. Te paraqitet kerkese ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor per depozitimin e ketij vendimi dhe te kontrates perkatese ne Rregjistrin Tregtar te kesaj gjykate.

Ne cilesine e Administratorit te Shoqerise, kerkoj te depozitoj ne rregjistrin tregtar vendimin e lartpermendur.

ADMINISTRATOR

Elona Mehlber

ELONA MEHLBER CAUSHI
ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION SHPK

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTERISE – Tirane

Notere Gentiana SHKODRA
Nr.305. rep
Nr.140.....kol

M.Shyri, No.44/1/1, Tirane, Shqiperi tel + 355 4 234847

Sot me date 20.03.2007 para meje notere Gentiana SHKODRA, me studio ne Tirane, ne adresen e larttreguar, u paraqit personalisht:

Znj. Elona Mehlber Caushi, e bija e Shpetimit, lindur ne Tirane, me 24.05.1971, banuese ne Tirane, Rr. Brigada 8, 7,3 me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes nr.Z1344896, ne cilesine e ortakut te vetem te Shoqerise "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" Sh.p.k., person juridik ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin nr.7719 date 02.10.1997, me seli te rregjistruar ne Tirane, ne adresen: Bulevardi Zogu I, Veve Business Center, e cila me kerkoi redaktimin e ketij

VENDIM TE ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" SHPK

Une Elona Mehlber Caushi, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" SHPK, shoqeri e krijuar me vendimin nr. 7719 date 02.10.1997 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, vendosa sa me poshte vijon:

1. Te pranoj shoqerine **"GEBR.HEINEMANN ALBANIEN HOLDING" Gmbh**, person juridik ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, rregjistruar ne Gjykaten e Hamburgut Gjermani, me numer rregjistri HRB 99537, me seli te rregjistruar ne adresen: Magdeburger Strasse 3, 20457 Hamburg, Gjermani, e perfaqesuar nga administratori i shoqerise Z.Jens Georg DEGNER.
2. Te nenshkruaj kontrate shitje kuotash ne favor te shoqerise **"GEBR.HEINEMANN ALBANIEN HOLDING" Gmbh** per nje total prej 70% te kuotave, per emimin kontraktor prej 70.000 (shtatedhjetemije) leke.
3. Me nenshkrimin e kontrates se shitjes se kuotave, pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise paraqitet si vijon:
   1. Elona Mehlber CAUSHI – 30% e kuotave te shoqerise
   2. GEBR. HEINEMANN ALBANIEN HOLDING SHPK – 70-% te kuotave te shoqerise.

   100% te kuotave te kapitalit te shoqerise
4. Znj. Elona Mehlber CAUSHI mbetet ne detyren e administratorit te shoqerise.
5. Te paraqitet kerkese ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor per depozitimin e ketij vendimi dhe te kontrates perkatese ne Rregjistrin Tregtar te kesaj gjykate.

Sa me lart lexohet prej meje noterit, kuptohet prej ortakut te vetem dhe nenshkruhet lirisht prej saj, perballe meje noterit. Ndersa une noteri e vertetoj nenshkrimin e saj dhe aktin sipas ligjit. Perpiluar ne kater ekzemplare me vlere te njejte ligjore:

ORTAKU I VETEM

ELONA MEHLBER CAUSHI

NOTERE

GENTIANA SHKODRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTERISE – Tirane

Notere Gentiana SHKODRA
Nr.384 rep
Nr.139...kol

M.Shyri, No.44/1/1, Tirane, Shqiperi tel + 355 4 234847

Sot, me date 20.03.2007 para meje notere Gentiana SHKODRA, me studio ne Tirane, ne adresen e lartpërcaktuar, u paraqiten personalisht:

1. **Znj. Elona Mehlber Caushi**, e bija e Shpetimit, lindur ne Tirane, me 24.05.1971, banuese ne Tirane, Rr. Brigada 8, 7,3 me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes nr.Z1344896, ne cilesine e ortakut te vetem dhe administratorit te Shoqerise "ALBANIAN DUTY FREE DISTRIBUTION" Sh.p.k., person juridik ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin nr.7719 date 02.10.1997, me seli te rregjistruar ne Tirane, ne adresen: Bulevardi Zogu I, Veve Business Center, ketu e ne vijim referuar si "Shitesi".
2. **Shoqeria "GEBR.HEINEMANN ALBANIEN HOLDING" Gmbh**, person juridik ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, rregjistruar ne Gjykaten e Hamburgut Gjermani, me numer rregjistri HRB 99537, me seli te rregjistruar ne adresen: Magdeburger Strasse 3, 20457 Hamburg, Gjermani, e perfaqesuar nga
   a- administratori i shoqerise Z.Jens Georg DEGNER, lindur ne Wermelskirchen, me 24.03.1965, banues ne Bramkappstieg 3a, 22949 Ammersbek, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. 1748802796, ne perputhje me prokuren nr. 465/2007 T date 19.03.2007 te noter Dr. Till Kleinstück, Hamburg, Gjermani.
   b- Claus Helmut Otto Heinemann, lindur ne Hamburg, me 07.08.1950, banues ne Faehrhansstr 23 a, 22085 Hamburg, me zotesi te pote jurdiike per t evepruar, mbajtes I pasaportes nr. Nr. 131231613, ne cilesine e ortakut te shoqerisei, ketu e ne vijim referuar si "Bleresi"

Palet asistohen nga perkthyes i licensuar i gjuhes gjermane

ndermjet te cileve eshte rene dakort dhe perpilohet sa me poshte vijon nje

KONTRATE SHITJE KUOTASH

(Bazuar ne:
a- bazuar ne nenet 705 e vijues mbi shitjen KC
b- N.47 i ligjit 7638 date 19.11.1992 mbi Shoqerite Tregtare)

Konstatime paraprake

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën ALL 100.000,- (me fjalë: njeqindmije Lekë) dhe është shlyer e paguar plotësisht.

Ortaku i vetëm i Shoqërisë është Shitësi, zonja Elona Mehlber – Çaushi, lindur në Tirane, Shqipëri, më 24.05.1971, shtetase shqiptare, banuese në Rr. Brigada 8, 7,3 Tirana, nr. pasaporte: Z 1344896.

Shitësi zoteron 100% te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 100.000, --- (me fjale: njëqindmijë Leke) i ndare ne 100 kuotra me vlere prej 1.000 leke secila (kuotat).

Per blerjen, kalimin si dhe transferimin e ketyre Kuotave Palet Konttraktuese lidhin kete kontrate me kushtet si vijon:

Blerja dhe transferimi i Kuotave

1.1 Shitësi i shet Blerësit 70 % [me fjalë: shtatëdhjetë përqind] të kuotave të Shoqerisë. Me këtë blerje Blerësi fiton të drejtën e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të Shoqërisë në masën 70% duke marrë pozicionin ligjor të ortakut maxhoritar të Shoqërisë. Shitja ka efekt ligjor dhe financiar ndërmjet Palëve Kontraktuese në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Efekti ligjor ndaj palëve të treta fillon vetëm pas regjistrimit të ndryshimit të ortakëve në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

1.2 Shitësi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që kalimi i Kuotave te Blerësi të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat ligjore dhe ato të parashikuara në këtë kontratë.

1.3 Në rastin e mos-hyrjes në fuqi të shitjes / transferimit të Kuotave të cilësuar në § 2.1 dhe në rastin e një mos-hyrjeje në fuqi, vërtetuar kjo me anë të një vendimi gjyqësor, Blerësi ka të drejtë të anullojë kontratën.

2. Çmimi i blerjes

